

**LIGJ**  
**Nr. 139/2016**

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE NR. 1 TË MARRËVESHJES  
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË  
SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR KONTROLLIN E LËNDËVE  
NARKOTIKE DHE ZBATIMIN E LIGJIT**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese nr.1 e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për kontrollin e lëndëve narkotike dhe zbatimin e ligjit

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 22.12.2016

**Shpallur me dekretin nr. 9942, datë 9.1.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani**

**MARRËVESHJE NDRYSHUESE NR. 1**

E MARRËVESHJES PËR KONTROLLIN E LËNDËVE NARKOTIKE DHE ZBATIMIN E  
LIGJIT, I DATËS 1 KORRIK 2015, NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS

**I. Informacion i përgjithshëm**

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (secila individualisht e referuar si "Pala" dhe kolektivisht si "Palët") bien dakord bashkërisht të modifikojnë dhe ndryshojnë marrëveshjen ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, të nënshkruar në datën 1 korrik 2015 (Marrëveshja) si më poshtë:

Me qëllim modifikimin e Programit për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale dhe shtesën prej 3 milion \$ për të zbatuar reformat gjyqësore;

Përshkrimi i plotë i projektit dhe objektivat e përmbushjes së objektivave janë përshkruar në seksionin II dhe III më poshtë. Ky ndryshim i marrëveshjes së datës 1 korrik 2015 nuk i ndryshon matjet e performacës të zbatueshme për projektet e renditura sipas marrëveshjes. Të gjitha detyrimet, afatet dhe kushtet e tjera në përmbajtje të marrëveshjes së datës (data) do të mbeten të zbatueshme dhe në fuqi dhe efekt të plotë. Sigurimi i financimit të qeverisë së SHBA-së pas vitit aktual fiskal kushtëzohet nga progresi i kënaqshëm në drejtim të objektivave të projektit dhe disponueshmërisë së fondeve të autorizuara dhe të ndara mbi bazë vit pas viti nga Kongresi i SHBA-së dhe të miratuara nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Palët bien dakord që për këto qëllime mund të sigurohen fonde shtesë, në bazë të të njëjta termave dhe kushteve të përcaktuara në Marrëveshjen, e ndryshuar, pa qenë e nevojshme më pas të ndryshojë marrëveshjen për të pasqyruar shumën e fondeve të siguruara. Qeveria e SHBA-së do të njoftojë Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, kur duhet të jepen burime shtesë në mbështetje të këtyre

projekteve.

## II. Përshkrimi i projektit

Programi për zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale

Programi për zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale (SDP) do të sigurojë asistencë për institucionet kryesore të drejtësisë penale të Shqipërisë, zyrtarët e antikorrupsionit dhe agjencitë mbështetëse për të forcuar kapacitetin e Shqipërisë për të luftuar të gjitha format e krimit, në veçanti duke u fokusuar në përmirësimin e efektivitetit dhe cilësisë së procedimeve penale dhe forcimin institucional në këtë kuadër. Rezultatet e projektit do të përfshijnë trajnimin, dhurimin e pajisjeve, asistencën teknike dhe këshillimin nga ekspertë të fushave, duke përfshirë ekspertët e Shteteve të Bashkuara, pjesëmarrës nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme për Fqinjësinë dhe Bisedimet për Zgjerim të Komisionit Evropian.

Masat e ndërmarra në mbështetje të kësaj iniciative përfshijnë zbatimin e pesë (5) komponentëve: 1. Rritja e kapacitetit të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimet e organizuara, korrupsionin dhe format e tjera të aktiviteteve kriminale; 2. Zhvillimi i një sistemi të drejtësisë penale nëpërmjet legjislacioneve të përmirësuara; 3. Ndihma ndaj gjyqësorit për të gjykuar rastet brenda afateve kohore, në mënyrë efikase, të paanshme dhe etike; 4. Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi; dhe 5. Monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrja për vetëkëqyrjen/verifikimin e gjyqësorit në koordinim me Komisionin Evropian.

Programi për zhvillimin e sistemit të drejtësisë kriminale do të marrë plotësisht në konsideratë bisedimet për anëtarësim ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, në mënyrë të veçantë planet e veprimit të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë për kapitullin 23 (Gjyqësori dhe të drejtat themelore) dhe kapitullin 24 (Drejtësia, liria dhe siguria) të *Acquis Communautaire (legjislacionit të Bashkimit Evropian)*. Gjithashtu, SDP do të sigurojë ekspertizë sa herë që është e përshtatshme dhe e mundur.

Për këtë qëllim, Qeveria e SHBA-së dhe Qeveria e Shqipërisë do të ndërmarrin veprime dhe do t'i përdorin burimet mbi baza vjetore, siç autorizohet nga proceset e tyre përkatëse legjislative për të mbështetur këtë përpjekje.

Masat që duhet të merren përfshijnë:

- Mbështetjen dhe financimin e projekteve për Zhvillimin e Sektorit të Drejtësisë Penale për të zbatuar komponentët e përshkruar më sipër.

## III. Objektivat e përmbushjes së projektit dhe verifikimi i arritjeve

Qëllimi afatgjatë i këtij projekti është forcimi i sektorit shqiptar të drejtësisë penale, institucionet dhe zyrtarët e tij, në mënyrë që të përgjigjet për të gjitha llojet e krimit, me fokus të veçantë në korrupsionin dhe krimin e organizuar, duke synuar ta afrojë vendim më pranë anëtarësimit në Bashkimin Evropian, në përputhje me qasjen strategjike të vendit. Një plan menaxhimi i performancës (PMP) i referuar edhe si një plan monitorimi dhe vlerësimi (M&V) për menaxhimin e procesit të mbledhjes së të dhënave, si dhe mbledhjen dhe rregullimin e të dhënave, do të zbatohet për çdo projekt.

Komponenti I i Projektit: Rritja e kapacitetit të prokurorëve dhe hetuesve për të luftuar krimin e organizuar, korrupsionin dhe format e tjera të aktivitetit kriminal.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është zhvillimi i një qasjeje gjithëpërfshirëse për trajnimin, orientimin dhe këshillimin për prokurorët dhe hetuesit.

Komponenti 2 i Projektit: Zhvillimi i sistemit të Drejtësisë Penale nëpërmjet përmirësimit të legjislacionit.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është dhënia e kontributit dhe këshillimit për hartimin e ligjit themelor të drejtësisë penale, politikave dhe kodit etik.

Komponenti 3 i Projektit: Ndihma ndaj gjyqësorit për gjykimin e çështjeve në kohë, në mënyrë efikase, të paanshme dhe etike.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është rritja e transparencës dhe të kuptuarit e përgjegjësisë dhe llogaridhënies së gjyqësorit.

Komponenti 4 i Projektit: Rritja e aksesit të qytetarëve në drejtësi.

- Objektivi i këtij komponenti të Projektit është rritja e aksesit të qytetarëve shqiptarë në drejtësi.

Komponenti 5 i Projektit: Monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrja për vettingun e gjyqësorit në koordinimin me Komisionin Evropian.

- Objektivi i këtij komponenti të projektit është monitorimi i zbatimit të reformave gjyqësore dhe mbikëqyrjes për vettingun e gjyqësorit, në koordinim me Komisionin Evropian.

#### IV. Vlerësimi i programit

Përfaqësuesit e palëve do të takohen dy herë në vit për të rishikuar progresin ndaj arritjes së objektivave të projektit. Një raport me shkrim mbi këto takime do të përgatitet dhe do t'i jepet palëve përkatëse. Progresi do të vlerësohet në përputhje me parametrat e arritjes të përshkruara më sipër. Informacioni që duhet të shqyrtohet gjatë kryerjes së këtyre vlerësimeve do të përfshijë tregues cilësorë dhe sasiorë. Këto vlerësime i shtohen monitorimit të vazhdueshëm të programeve dhe aktiviteteve nga personeli përkatës i të dy qeverive. Në këtë kontekst, një punë praktike nga ana e përfituesve do të ndiqet me synimin e evidentimit të ndryshimeve që mund të lidhen me ushtrimin e aftësive dhe njohurive të reja (për shembull, zbatimin e standardeve ndërkombëtare në të drejtat e njeriut dhe fusha të tjera, kohës së nevojshme për kryerjen e hetimeve, numrin e padive të depozituara dhe të gjykuara, si dhe arritjes e ngjashme të identifikueshme).

Bërë në dy kopje në Tiranë, Shqipëri më datë 21 të muajit shtator të vitit 2016, në gjuhën angleze dhe shqipe ku të dy tekstet janë njëlloj autentike.

PËR QEVERINË E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME  
**Saimir Tahiri**

PËR QEVERINË E SHTETEVE TË BASHKUARA  
AMBASADORI  
**Donald Lu**